

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - GUSHT 2025

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	03.08.2025	Kërkesë për informacion dhe dokumentacion mbi projektin.....	21.08.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj,dërguar nëpërmjet adresës elektronike, lutemi gjeni bashkëlidhur përgjigjen përcjellë me shkresë zyrtare;	E plotë	Nuk ka

2	05.08.2025	Kërkesë	18.08.2025	Në përgjigje të ankesës Suaj,..... Ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon; Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT),e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së, në mbështetje të VKM Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të AZHT" i ndryshuar, ka kompetencë <i>pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së.</i> Pranë AZHT është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik e-leje, aplikimi... Në vijim,në përputhje me Ligjin Nr.107/2024 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, KKTU, në mbledhjen...ka marrë vendimin.....në përputhje me Ligjin Nr.107/2024 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,..... Gjithashtu,ju bëjmë me dije se KKTU është organ kolegjal,që funksionon pranë Këshilli të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri.Vendimmarrja e sipërcituar është ndërmarrë pas një vlerësimi të përbashkët të anëtarëve të këshillit në zbatim të Ligjit Nr.107/2024 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Sqarojmë se,në lidhje me vendimmarrjen si dhe referuar Ligjit Nr.107/2024 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar, në Nenin nr.7,"Përgjegjësitë e KKTU",gërma ç),përcaktohet se: "<i>KKTU-ja vendos miratimin e <u>rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj</u></i>". Në përputhje me këtë dispozitë,Ju bëjmë me dije se në pikën Nr.2 të vendimit të sipërcituar,përcaktohet se pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe <i>Dokumenti i Rregullores së Veçantë</i> . Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm	E plotë	Nuk ka
---	------------	---------	------------	---	---------	--------

3	07.08.2025	Kërkesë për informacion dhe dokumentacion mbi projektin....	18.08.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj,..... Ju bëjmë me dije se: Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT),e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së, është krijuar me VKM Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të AZHT" i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar,kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së,me qëllimn shqyrtimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Pranë AZHT,është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve,aplikimi.... Në vijim,KKTU në mbledhjen...ka miratuar me kusht.....,i cili është në proces konfirmimi. Për sa më sipër,ju informojmë se sapo të përfundojë procesi i konfirmimit të Vendimit të KKTU.....,këto dokumenta do të publikohen (në mënyrë që të jenë të aksesueshme për të gjithë subjektet,ashtu sikurse të gjithë Vendimet e tjerë të KKT),në adresën zyrtare të AZHT:https://azht.gov.al,në rubrikën "Vendime KKT". Për çdo informacion që kërkon në lidhje me projektin,ju lutemi drejtohuni pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
4	11.08.2025	Pezullimin e procedurave administrative, zbardhjen e vendimit që kanë lidhje me lejen e zhvillimit dhe lejen e ndërtimit.....	18.08.2026	Në përgjigje të shkresës Tuaj,..... Ju bëjmë me dije se në lidhje me pretendimet tuaja ju kemi kthyer përgjigje me shkresën.....	E plotë	Nuk ka
5	11.08.2025	Kopje proces verbali ose vendimi që ka lidhje me lejen e zhvillimit si dhe lejen e ndërtimit.....	18.08.2026	Në përgjigje të shkresës Tuaj,..... Ju bëjmë me dije se në lidhje me pretendimet tuaja ju kemi kthyer përgjigje me shkresën.....	E plotë	Nuk ka

6	12.08.2025	Informacion	12.08.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj,dërguar nëpërmjet adresës elektronike, ju bëjmë me dije se informacionin për mbledhjet KKT e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit: http://www.azht.gov.al , në rubrikën "Njoftimet e fundit".	E plotë	Nuk ka
7	14.08.2025	Pezullim/Mos Dhënien e Lejes së Ndërtimit për pasuritë e mëposhtme.....	18.08.2027	Në përgjigje të kërkesës Suaj.....ju bëjmë me dije si vijon; AZHT,në bazë të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e territorit si dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të KKTU.Gjithashtu, referuar po këtij ligji,në nenin 28 të tij,ndër të tjera përcaktohen përgjegjësitë e KKTU: <u>Pika1. KKTU-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit, dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit,si dhe për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe ndërtimi për objektet brenda brezit të zhvillimeve të kontrolluara,sipas përkufizimit të ligjit për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare.KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në komeptencë të saj.</u> Për sa më lartë,referuar kërkesës Suaj,...pranë AZHT, pasi bëri verifikimet përkatëse në databazë, në pronën paraqitur grafikisht në shkresën Tuaj, nuk evidentoi asnjë aplikim apo vendimmarrje të KKTU. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
8	15.08.2025	Ankesë për bllokim rruge në Rrugën	18.08.2025	Në lidhje me ankesën Tuaj, drejtuar nëpërmjet adresës elektronike, lutemi të drejtoheni pranë Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Territorit (IMT).	E plotë	Nuk ka
9	19.08.2025	Kërkesë për leje ndërtimi	15.09.2025	Shënim: Në zbatim të Nenit 24, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se: “Kur një organ publik merr një kërkesë,për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet,ia përcjell kërkesën menjëherë,organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë” , kërkesa është përcjell në organin publik kompetent,ku dhe kërkuesi është vendosur në dijeni për këtë.	E plotë	Nuk ka

10	20.08.2025	Përshëndetje!	20.08.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj,dërguar nëpërmjet adresës elektronike, lutemi referojuni bazës ligjore bashkëlidhur ku gjendet informacioni i plotë dhe i saktë ligjor për aplikim për leje zhvillimi dhe ndërtimi, etj.. Në këtë dokument mund të informoheni mbi dokumentat e nevojshëm për aplikim, afatet e procesit nga momenti i aplikimit deri në finalizimin e tij, palët e përfshira në proces (zhvilluesi,projektuesë të licencuar dhe autoritetet vendimmarrëse) si dhe procesin e hartimit të dokumentacionit të kërkuar për aplikim në portalin elektronik të vetëm qeveritar "e-albania", në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit "E-Leje". Gjithashtu ju informojmë se për informacion dhe sqarim më të saktë, bashkë me dokumentat që zotëroni, mund të paraqiteni pranë sporteleve të informacionit të bashkisë përkatëse.	E plotë	Nuk ka
11	21.08.2025	Dhënie leje nga bashkia..për kioskë	22.08.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj dërguar nëpërmjet adresës elektronike, Ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon; Referuar Nenit 27, të Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë përkatësisht: Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Kryetari i Bashkisë. Mbështetur në legjislacionin mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit, këto dy autoritete (KKT dhe Kryetari i Bashkisë), nuk janë në pozita varësie me njëri-tjetrin pra, KKT nuk është organ epror i Kryetarit të Bashkisë dhe si rrjedhojë AZHT në cilësinë e Sekretariatit Teknik nuk mund t’ju diktojë vullnetin e saj Bashkive në drejtim të interpretimit apo zbatimit të kuadrit ligjor. Sa më sipër, sa i takon çështjes suaj, Ju sugjerojmë ti drejtoheni Bashkisë, si autoriteti përgjegjës për vendimarrjen sipas fushës së kompetencës brenda territorit të saj administrativ dhe legjislacionit sektorial në fuqi.	E plotë	Nuk ka

12	21.08.2025	Pezullimi dhe rishikimi i lejes së ndertimit të objektit....	29.08.2025	Në përgjigje të ankesës Suaj,...Ju bëjmë me dije,si më poshtë vijon; Sikurse ju kemi bërë me dije edhe në korrrespondencat e mëparshme, AZHT, e cila aktualisht funksionin si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, në mbështetje të Vendimin Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, ka kompetencë <i>pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së</i> . Pranë AZH,është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik e-leje aplikimi.... Gjithashtu,ju bëjmë me dije se KKTU është organ kolegjial,që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri.Vendimmarrja e sipërcituar është ndërmarrë pas një vlerësimi të përbashkët të anëtarëve të këshillit në zbatim të ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Sqarojmë se,në lidhje me vendimmarrjen si dhe referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar,në Nenin Nr.28 "Përgjegjësitë e KKTU",pika 3,përcaktohet se:"KKTU-ja vendos miratimin e <u>rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit</u> për rastet kompetencë e saj"	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	---------	--------

13	21.08.2025	Shfuqizimin nga KKT të lejes së ndërtimit të miratuar nga KKT....	04.09.2025	 Sqarojmë se AZHT kryen funksionin e Sekretariatit Teknik të KKT dhe në përputhje me VKM Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të AZHT " i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar,kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit tekniko-ligjor që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKT. Në përgjigje të kërkesës Suaj,ju bëjmë me dije se në sistemin elektronik e-leje është depozituar aplikimi..... Në vijim,në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,..... Së fundmi,ju informojmë se AZHT nuk do të vijojë me procedurat e mëtejshme pa u plotësuar i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor.	E plotë	Nuk ka
14	22.08.2025	Shënim : kërkesë pa objekt	25.08.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj dërguar nëpërmjet adresës elektronike, Ju bëjmë me dije se për informacion rreth ndryshimit të destinacionit të pronësisë të drejtoheni pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK);	E plotë	Nuk ka
15	26.08.2025	Kërkesë			Në proces	Nuk ka
16	29.08.2025	Ankesë për zaptimin e hapësirave publike	01.09.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj dërguar nëpërmjet adresës elektronike, Ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon; Referuar Nenit 27, të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë përkatësisht: Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Kryetari i Bashkisë. Mbështetur në legjislacionin mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit, këto dy autoritete (KKT dhe Kryetari i Bashkisë), nuk janë në pozita varësie me njëri-tjetrin pra, KKT nuk është organ epror i Kryetarit të Bashkisë dhe si rrjedhojë AZHT në cilësinë e Sekretariatit Teknik nuk mund t'ju diktojë vullnetin e saj Bashkive në drejtim të interpretimit apo zbatimit të kuadrit ligjor. Sa më sipër, sa i takon çështjes suaj, Ju sugjerojmë ti drejtoheni Bashkisë përkatëse, si autoriteti përgjegjës për vendimarrjen sipas fushës së kompetencës brenda territorit të saj administrativ dhe legjislacionit sektorial në fuqi.	E plotë	Nuk ka